




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 13, pika 13.8 të Ligjit nr. 2003/14, për planifikimin hapësinor, të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-106, për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor, të nenit 17, pika 17.1, shkronja **b**, të Ligjit nr. 03 L-040, për vetëqeverisje lokal, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28 / 2008) dhe të nenit 15, pika 15.1, shkronja **b** të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01 - 110 - 391, të dt. 25. 2. 2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24.6.2010, merr

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES PËR LAGJEN
"MUHAXHIRËT" NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Plani rregullues për lagjen "Muhaxhirët " në Prishtinë.
Plani, nga paragrafi 1 i këtij neni, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

Neni 2

Rregullimi dhe realizimi i hapësirës së përfshirë brenda kufijve të Planit rregullues nga neni 1 i këtij Vendimi, do të bëhet nga organi kompetent komunal i Prishtinës për punë të planifikimit dhe urbanizmit, bazuar në kushtet urbanistiko-teknike, të përcaktuara me Plan, lejet urbanistike dhe proceset përcjellëse, në përputhje me ligjet e lartcekura.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës, të cilat do t'i kryejnë veprimet e nevojshme për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e miratimit të tij në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

Ditën e miratimit të këtij Vendimi, pushojnë të vlejnë planet ekzistuese urbanistike për kompleksin e përfshirë brenda kufijve të Planit rregullues të miratuar me këtë Vendim.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 nr. 35-1299, më 29.06.2010

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS
Sami Hamiti, ecc. i dipl.